



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 13.12.2022

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 13.12.2022, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 257, datë 12.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Miranda Andoni

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 9.7.2020, është njoftuar vendimi nr. 257, datë 12.6.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me anë të së cilit është konfirmuar në detyrë subjekti i rivlerësimit znj. Miranda Andoni, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar ankim, pasi vlerëson se procesi i hetimit administrativ i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i plotë. Për rrjedhojë, përfundimet e arritura për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara, me qëllim krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kuptim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e tij, çmon se vendimi nr. 257/2020 përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu nënshtruar

juridiksionit rivlerësues dhe kontrollues nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, e për këto arsye, i kërkojmë Kolegjit të riçelë hetimin gjyqësor dhe vlerësimin e çështjeve, si më poshtë:

I. Për kriterin e pasurisë

1. Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara dhe rrethanat e çështjes, konstaton se hetimi administrativ i kryer nga Komisioni ka qenë i mangët, pasi nga korrespondenca e ndjekur me OSHEE-në, rezulton se kjo e fundit, me shkresën me nr. *** prot., datë **.10.2019, ka konfirmuar disa kontrata furnizimi të energjisë elektrike në emër të personave të lidhur të subjektit të rivlerësimit, për të cilat Komisioni nuk ka hetuar apo vlerësuar më tej këto të dhëna. Ndërsa me UKT-në mungon verifikimi i ekzistencës së kontratave të lidhura nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

2. Nga korrespondenca e Komisionit me Drejtorinë e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), kjo e fundit, me shkresën me nr. *** prot., datë **.10.2019, ka konfirmuar se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, del si palë nënshkruese në disa kontrata kredie, ku sipas informacionit të dokumentuar, për kontratën e datës **.6.2012, me vlerë 2.400.000 lekë, burimi i fondeve përshkruhet si: “të ardhura familjare”. Ky informacion nuk përputhet me informacionin e konfirmuar nga DPPPP-ja, me shkresën me nr. ***, datë **.5.2017, dërguar ILDKPKI-së, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

3. Sa më sipër, rezulton se këto të dhëna nuk janë hetuar nga Komisioni, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve që kanë lidhje me rrethanat e çështjes, në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë apo të vlerësimit të përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas përcaktimit të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Vlerësimi i këtyre rrethanave merr rëndësi në rastin konkret, pasi ato do të ndikonin në vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive dhe shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

4. Për sa i përket çështjeve të hetuara dhe për të cilat subjektit i ka kaluar barra e provës, bazuar mbi të njëjtat prova të administruara, Komisioneri Publik ndan gjykim të ndryshëm me përfundimet e arritura nga Komisioni në lidhje me pasuritë *apartment banimi* me sip. 123.5 m² dhe *garazh* me sip. 26.9 m², të ndodhur në Tiranë.

4.1 Rezulton se në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: Apartament banimi me sip. 123.5 m², në adresën: Rr. “****”, *** ***, Tiranë, blerë me kontratë shitje nr. ***/***, datë **.6.2008. *Vlera* 105.600 euro, *Pjesa takuese* 50%. *Garazh*, vendparkim automjeti (në bashkëpronësi me bashkëshortin, ***.***), me sip. 26.9 m², me adresë: Rr. “****”, *** ***, Tiranë, blerë me kontratë shitjeje nr. ***/***, datë **.6.2008, në vlerën 13.000 euro. *Pjesa takuese*: 50%. *Burimi i krijimit*: të ardhura nga kursimet familjare ndër vite, nga pagat, gjendje në llogari bankare në *** Bank. *Burimi i krijimit*: kredi dhe kursimet familjare ndër vite, nga pagat familjare.

4.2 Në deklaratën e interesave periodikë 2008, subjekti ka deklaruar: Apartament banimi, ***, Tiranë, me sip. 123.5 m², kontratë shitjeje nr. ***/***, datë **.6.2008. *Vlera* 105.600 euro. *Pjesa*

takuese 50%. Garazh, ***, Tiranë (në bashkëpronësi me bashkëshortin, ***.***), me sip. 26.9 m², me adresë: Rr. “****”, *** ***, Tiranë, blerë me kontratë shitje nr. ***/***, datë **.6.2008, Vlera 13.000 euro. *Pjesa takuese*: 50%. *Burimi i krijimit*: nuk deklarohet.

4.3 Në vlerësim të burimit të ligjshëm të deklaruar për krijimin e këtyre dy pasurive, kredi dhe kursimet familjare ndër vite, Komisioni, në përfundim, ndër të tjera, ka vlerësuar se:

4.3.1 Subjekti nuk ka pasur asnjë arsye dhe motiv për të fshehur në Deklaratën “Vetting” shumën (3.870 euro), e dhënë nga nëna e saj në vitin 2008, përkundrazi, mungesa e deklarimeve në lidhje me këtë shumë e ka vënë në kushtet e pasaktësisë në deklarim.

4.3.2 Për sa i takon ligjshmërisë së burimeve financiare për krijimin e kësaj shume të dhënë subjektit nga personi tjetër i lidhur, znj. ***.***, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor justifikues të ardhurat e ligjshme të vëllezërve nga emigracioni,¹ dhe se kjo shumë nuk mbulohet me burime të ligjshme.

4.3.3 Nga analiza financiare deri në datën 12.6.2008, fillimisht, Komisionit i ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet e jetesës dhe pagesat për një diferencë negative prej - 201.859 lekë. Por pasi ka analizuar dhe marrë në shqyrtim shpjegimet dhe provat e subjektit, ka vlerësuar të marrë në konsideratë pretendimet e subjektit mbi të ardhurat nga interesat bankare dhe të ardhurat nga qiratë për periudhën janar 2008 - qershor 2008, në shumën prej 102.000 lekësh, tatimi për të cilat është paguar gjatë procesit të vlerësimit në datën 6.3.2020. Pas rishikimit të këtyre treguesve, Komisionit i ka rezultuar se balanca negative, për periudhën deri në 12.6.2008, është në shumën prej 89.908 lekë.

5. Komisioneri Publik, në lidhje me burimin e deklaruar si kursime familjare ndër vite, konstaton se rezultatet e analizës financiare të Komisionit nuk mbështeten në gjendjen faktike të akteve në dosje.

5.1 Referuar dhe në konkluzionet e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë që personi tjetër i lidhur, nëna e saj, mbulon me burime të ligjshme shumën e dhënë në formë ndihme/hua,² vlerën 3.780 euro, nisur nga fakti se kjo shumë është depozituar në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit dhe është pjesë e zërit të analizës “shtesa/pakësime likuiditete”, si e tillë, vlerësojmë se në këtë zë, e gjithë shuma prej 3.780 euro ose vlera e konvertuar në lekë, nuk duhet të konsiderohet si burim i ligjshëm i pagesës së blerjes të pasurive *apartment* dhe *garazh*.

5.2 Për sa i përket vlerësimit të Komisionit mbi zërin “të ardhura nga qiratë”, referuar dhe qëndrimeve të mbajtura nga Kolegji³ në raste të ngjashme, vlerësojmë se në analizën financiare të burimeve të ligjshme të krijimit të pasurive deri në periudhën e kryerjes së pagesës, në qershor

¹ Subjekti ka paraqitur: kopje të dy pasaportave ndërkombëtare të skaduara të vëllait, z. ***.***, me të cilat vërtetohen lëvizjet e këtij shtetasi në Greqi për periudhat 2005 – 2015 dhe 2009 – 2019; dokument në gjuhën greke (kartë greke) të shtetasit ***.***, në shtetin grek, me afat vlefshmërie 2006 – 2015; vërtetim të lëshimit të numrit të regjistrimit tatimor grek të vitit 2002 për shtetasin ***.***, datë **.8.2002; vërtetim regjistrimi të të siguruarit ***.***, në shtetin grek, datë **.4.2004.

² Në DV- 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Ndihmë monetare nga nëna ime ***. (***) ***, për pagesën e këstit të parë të apartamentit 3870 euro”. Ndërsa në parashtrimet e datës 10.3.2022, subjekti ka deklaruar se këtë shumë e ka marrë hua nga nëna e saj.

³ Për më tepër referohuni në vendimin (JR) nr. 8/2019 etj.

2008, nuk duhet konsideruar shuma 102.000 lekë, e pretenduar nga subjekti si e ardhur nga qiradhënia, pasi rezulton se për to, detyrimet tatimore janë paguar gjatë procesit të rivlerësimit.

5.3 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se në analizën financiare mbi mundësinë e subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme pagesat e kryera në vitin 2008, dy shumat prej 3.780 euro dhe 102.000 lekë, nuk duhen të përfshihen në mesin e të ardhurave të ligjshme, duke rezultuar kështu me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në këtë masë, për të justifikuar pasuritë.

5.4 Lidhur me burimin e deklaruar si kredi bankare dhe shlyerjen e saj ndër vite, përpos sa është konstatuar nga Komisioni mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për mbulimin e shpenzimeve në vitin 2010,⁴ nga vlerësimi i të dhënave, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe shlyerjet e parakohshme të kredisë edhe për vitin 2011, në shumën – 408.153 lekë⁵, si dhe për vitin 2016, në shumën – 139.631 lekë⁶.

6. Duke përfunduar për kriterin e pasurisë, rezulton se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke mos mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe investimet e deklaruar për vitet 2008 - 2016. Kjo pamjaftueshmëri, në varësi edhe të rezultateve të hetimit të kërkuara më sipër, do të ndikonte në vlerësimin përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, edhe në këndvështrim të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

II. Për vlerësimin e aftësive profesionale

7. Nga hetimi administrativ i Komisionit për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, për subjektin e rivlerësimit, znj. Andoni, kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, për të cilat subjekti i janë kërkuar shpjegime. Referuar burimeve të vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, raportvlerësimit të KLD-së, hetimit administrativ të Komisionit, si dhe të dhënat e dala nga denoncimet e publikut, problematikat dhe mangësitë e konstatuara janë si vijon:

⁴ Referohuni analizës financiare në tabelën përmbledhëse në f. 24, të vendimit të Komisionit.

⁵ Në analizën e këtij viti janë llogaritur si të ardhura shuma 3.193.528 lekë, e përbërë nga të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortit sipas vërtetimeve të institucioneve përgjegjëse, si dhe të ardhurat nga qiraja. Në zërin: shpenzime në shumën 2.699.632 lekë janë përfshirë shpenzime jetese sipas përbërjes familjare, shpenzime për shlyerjen e kështit të kredisë, verifikuar nga lëvizjet e llogarive bankare, dhe shpenzime udhëtimi, bazuar në jurisprudencën e KPA-së, si dhe janë zbritur ndryshimet e balancave të llogarive bankare si kursim i llogaritit midis diferencës së gjendjes, datë 31.12.2011 dhe 31.12.2010, llogaritur në shumën rreth 902.000 lekë, bazuar në konfirmimet e institucioneve financiare të gjendura në dosjen e KPK-së.

⁶ Në analizën e këtij viti janë llogaritur si të ardhura shuma 3.314.583 lekë, e përbërë nga të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortit dhe së bijës, sipas vërtetimeve të institucioneve përgjegjëse, si dhe të ardhurat nga qiraja. Në zërin: shpenzime në shumën 3.171.407 lekë janë përfshirë shpenzime jetese sipas përbërjes familjare, shpenzime për shlyerjen e kështit të kredisë, verifikuar nga lëvizjet e llogarive bankare, shpenzime për shkollimin e fëmijëve sipas akteve të depozituara në dosje dhe shpenzime udhëtimi, bazuar në jurisprudencën e KPA-së, si dhe janë zbritur ndryshimet e balancave të llogarive bankare si kursim i llogaritit midis diferencës së gjendjes, datë 31.12.2016 dhe 31.12.2015, llogaritur në shumën rreth 283.077 lekë, bazuar në konfirmimet e institucioneve financiare të gjendura në dosjen e KPK-së.

7.1 Lidhur me treguesin, aftësitë profesionale - *arsyetimi ligjor*, referuar të dhënave nga shorti i pesë dosjeve gjyqësore, rezulton se për dosjet nr. 1⁷, nr. 3⁸ dhe nr. 4⁹, vendimet e ndërmjetme arsyetohen nga ana e subjektit të rivlerësimit në nivelin minimal dhe, në përgjithësi, atyre iu mungon referenca ligjore. Ndërsa për dosjet nr. 2¹⁰ dhe nr. 5¹¹, subjekti nuk disponon me vendime të ndërmjetme. Në pjesën hyrëse të vendimit mungon data e regjistrimit të çështjes, gjeneralitetet e plota të palëve apo aktet e përfaqësimit të tyre.

7.2 Lidhur me treguesin, *aftësitë organizative, aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të kryer procedurat gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet*, nga vëzhgimi i pesë dosjeve, është konstatuar se për dosjen nr. 1, nr. 3 dhe nr. 4, subjekti i ka arsyetuar vendimet gjyqësore jashtë afatit ligjor. Subjekti nuk disponon me vendim/urdhër formal për caktimin e seancës dhe nuk kujdeset që aktet e njoftimit të përfshihen rregullisht në dosje. Mangësitë në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të, janë të njëjta në dosjet e vëzhguara si: aktet e njoftimit të palëve mungojnë në dosje apo nuk përfshihen në dosje lista e shpalljeve, nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes etj.

7.3 Lidhur me treguesin, *aftësitë personale dhe angazhimi profesional - aftësia për të bashkëpunuar*, në dosjet nr. 1, nr. 3 dhe nr. 4 është konstatuar vonesë në depozitim të tyre në sekretarinë gjyqësore.

7.4 Lidhur me tri vendimet/dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se¹²:

7.4.1 Çështja civile me palë paditëse dhe kundërpaditëse ****.**** dhe ****.****, me objekt: “kallëzim i një punimi të ri”, regjistruar më datë ****.4.2013 dhe përfunduar më datë ****.4.2014, ka zgjatur 1 vit e 20 ditë. Periudhë nga e cila, pas marrjes së çështjes nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e relatores, çështja ka zgjatur 9 muaj e 20 ditë. Pra, në tejkalim të afatit 6-mujor të gjykimit civil, referuar vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, të KLD-së;

7.4.2 Çështja penale me të pandehurin ****.****, gjykuar për veprën penale: “vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, regjistruar më datë ****.3.2014 dhe përfunduar më datë ****.2.2015, ka zgjatur 11 muaj e 7 ditë. Pra, në tejkalim të afatit 6-mujor të parashikuar për gjykimet penale në Gjykatën e Apelit.

⁷ Kjo dosje i përket çështjes civile me nr. ****/...-2013*, që i përket kërkesës ****.****, dhe personit të tretë ****.****, me objekt: “rivendosje në afat të kërkesës për ankim ndaj vendimit...”.

⁸ Kjo dosje i përket çështjes penale me nr. ****/-2015*, që i përket të pandehurit ****.****, i akuzuar për veprën penale të: “shitjes së narkotikëve, të kultivimit të bimëve narkotike, të mbajtjes pa leje të armëve luftarake...”.

⁹ Kjo dosje i përket çështjes civile me nr. ****/...-2015*, që i përket palës paditëse *“***... sh. a.”*, kundër palës të paditur *“***... sh.p.k.”*, me objekt: “përmbushje detyrimi monetar...”.

¹⁰ Kjo dosje i përket çështjes civile me nr. ****/...-2014*, që i përket palës paditëse ****.****, kundër palës të paditur ****.****, me objekt: “zgjidhje martesë...”.

¹¹ Kjo dosje i përket çështjes penale me nr. ****...-2016*, që i përket të pandehurit ****.****, i akuzuar për veprën penale të “mosbindjes ndaj urdhrit të punonjësit të policisë...”.

¹² Për më tepër referohuni në pikën 2, të f. 32, të vendimit të Komisionit.

7.5 Tejkalim në afatet e gjykimit janë konstatuar edhe për raste të tjera, pasi nga burimet arkivore të KLD-së ka rezultuar, ndër të tjera, se janë regjistruar tri ankesa të vitit 2016, të cilat, pasi janë verifikuar për zvarritje gjykimi, në përfundim janë regjistruar për vlerësim profesional dhe etik për subjektin e rivlerësimit.

7.6 Komisioni, për sa më sipër, ndër të tjera, ka mbajtur qëndrimin se, për tejkalimin e afateve të gjykimit, ka krijuar bindjen se zgjatja e afateve në çdo rast nuk ka qenë për faj apo neglizhencë të subjektit të rivlerësimit, por ka ndodhur për shkaqe të përlligjura. Për sa i takon mangësive të tjera të vërejtura, Komisioni ka vlerësuar se këto parregullsi nuk tregojnë që subjekti ka njohuri, aftësi në gjykim, qëndrime ose modele pune të dobëta, të tilla sa të kenë rrezikuar dhe cenuar të drejtat e qytetarëve apo ato të jenë bërë pengesë në mbarëvajtjen e proceseve.

7.7 Ndërsa për faktet e rrethanat e dala nga denoncimet e publikut, për një rast, Komisioni, pasi ka konstatuar se seanca gjyqësore është zhvilluar pa dijeninë e rregullt të personit të tretë, denoncuesit, ka vlerësuar se subjekti nuk ka përmbushur detyrimet e nenit 4 të Kodit të Procedurës Civile, e për këtë arsye, ka vendosur transferimin e çështjes pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

8. Komisioneri Publik, duke konsideruar se shkaqet e ankimit do të mundësojnë për Kolegjin të vendosë nëse rezultati i vlerësimit të aftësive profesionale në rastin konkret është i justifikuar, parë kjo edhe në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve, ndan qëndrim të ndryshëm me përfundimet e arritura nga Komisioni.

8.1 Bazuar në gjetjet dhe mangësitë e konstatuara nga KLD-ja, të konfirmuara dhe nga hetimi administrativ i Komisionit, në pamundësi të vlerësimit të dosjeve fizike objekt vlerësimi, Komisioneri Publik është ndalur në faktin e konstatuar të tejkalimit të afateve të gjykimit, si model i vërejtur në më shumë se një herë në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi kjo rrethanë, së bashku dhe me mangësitë e tjera, në këndvështrim të nenit E, pika 5 të aneksit të Kushtetutës, përbën cenim të së drejtës së qytetarëve për një gjykim të drejtë brenda afateve të arsyeshme. Parimi i zhvillimit të procesit brenda afateve të arsyeshme është një parim kushtetues, respektimi i të cilit mundëson realisht vënien në vend të të drejtave të personave, detyrimi i përcaktuar në nenin 42/2 të Kushtetutës, nenin 6 i KEDNJ-së, si dhe nga neni 28 i Kodit të Procedurës Civile.

8.2 Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik, mbështetur në standardet e përcaktuara në nenin 74 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, vlerëson se është përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit që, për secilin rast të trajtuar, duhet të kishte marrë masa për të shmangur shkeljen e afateve të gjykimit të çështjes, të arsyetonte vendimet e ndërmjetme me bazën ligjore përkatëse, të kujdesej për aktet dhe efektivitetin e njoftimit të palëve, arsyetimit në kohë të vendimeve dhe dorëzimit të dosjeve, verifikimit të plotësisë dhe korrektësisë së dosjeve gjyqësore, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të procesit gjyqësor.

8.3 Mangësitë e vërejtura paraqiten të natyrës përsëritëse, dhe si të tilla, të vlerësuara së bashku me mangësitë e konstatuara në çështjen civile nr. ***, të vitit 2015, çështje e transferuar nga

Komisioni pranë organit kompetent për inspektim, sipas nenit 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve, mund të çojnë në një vlerësim të ndryshëm nga sa ka arritur Komisioni.

III. Përfundime

9. Mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 84/2016, kërkojmë që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke disponuar riçeljen e hetimit gjyqësor dhe eventualisht administrimin e provave të nevojshme.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO